



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

Nr. 06- 29633 / 26

Klinë, datë: 10, 09, 2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i shtatë publik për kornizen afatmesme buxhetore te vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave, Sferkë, Gllarevë, Ceravik, Volljakë, Zabërgj, Përqevë, Stapanic, Rixhevë, Qupevë te komunës së Klinës, me, datë 01.09.2026, ora 18:00, shkolla fillore "Emin Duraku" Sferkë.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 07/09/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i Draft-Buxhetit i vitev 2027-2029 i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft-buxheti edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 18:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 10 persona, prej të cilëve, 10 burra,

Shtojca 7 – Fotografi nga dëgjim i shtatë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave: Sferkë, Gllarevë, Ceravik, Volljak, Qupevë, Zabergj, Rixhevë, Stapanic, Përgevë e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:

Të nderuar banorë të Sferkës, Gllarevës, Caravikut, Volljakës, Çupevës, Zabërgjës, Rixhevës, Stapanicit dhe Përqevës, ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe interesimin tuaj për zhvillimin e komunës sonë sot po diskutojmë Draft-Buxhetin e Komunës së Klinës për vitin 2027, me qëllim që investimet dhe projektet të jenë sa më afër nevojave të qytetarëve. Në fokus duhet të jenë përmirësimi i rrugëve dhe infrastrukturës, ndriçimi publik, ujësjellësi dhe kanalizimi, përmirësimi i kushteve në shkolla dhe hapësirave sportive, mbështetja e bujqësisë dhe ekonomisë lokale, si dhe investimet e barabarta në të gjitha fshatrat. Mendimi dhe kërkesat e banorëve janë shumë të rëndësishme. Prandaj, dëshirojmë t'i dëgjojmë problemet dhe propozimet tuaja, në mënyrë që ato të merren parasysh gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2027.

Diskutimet e pjesëmarrësve

Sadri Berisha, Dush i Sferkës

Kërkesa ime është që të rregullohet ndriçimi publik dhe të zgjidhet problemi i dy deponive të mbeturinave në fshatin tonë.

Pergjigja e Kryetarit:

Faleminderit, Sadri, e kemi në projekt ndriçimin e tërë fshatit, po ashtu edhe trotualet kemi ndarë një fond të veçantë për ndriçimin dhe trotualet dhe po mendojmë që të vendosim drita solare, të cilat furnizohen me rreze të diellit, nuk krijojnë shpenzime për energji elektrike dhe janë më të qëndrueshme sa i përket deponive, kam kërkuar nga Ministria e Mjedisit që të na lejojë hapjen e dy deponive, në mënyrë që qytetarët të kenë ku t'i hedhin mbeturinat në mënyrë të rregullt, gjithashtu, kemi një marrëveshje me KRM Ambjenti, ku Komuna do të blejë një bager, ndërsa KRM Ambjenti do të sigurojë një kamion. Në këtë mënyrë do të mund t'i mbledhim mbeturinat në të gjithë territorin e Komunës së Klinës. Bageri do të shfrytëzohet edhe për krasitjen, pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve rajonale në territorin e komunës sonë.

Emin Balaj, Gllarevë

Një nga kërkesat kryesore për fshatin tonë, Gllarevën, është sigurimi i ujit të pijshëm

Pergjigja e Kryetarit: Faleminderit, Emin, sa i përket ujit të pijshëm, e kuptoj shumë mirë këtë shqetësim. Mirëpo, një fakt është se Kompania Rajonale e Ujësjellësit është nën përgjegjësinë e nivelit qendror dhe, për fat të keq, deri tani nuk kemi pasur mbështetjen e nevojshme nga kjo kompani për ta zgjidhur këtë problem shqetësimi ynë tjetër është se një pjesë e madhe e buxhetit të Komunës është e ngarkuar me obligime që rrjedhin nga lëndët përmbartimore dhe Kontrata Kolektive, gjë që na kufizon shumë mundësitë për investime të mëdha megjithatë, si kryetar i komunës, jam duke u angazhuar me të gjitha forcat për të gjetur një zgjidhje. Kam kërkuar mbështetje edhe nga Qeveria e Kosovës dhe nga ministratë përkatëse, që të na mbështesin në një projekt për furnizimin me ujë të pijshëm në të gjithë territorin të Klinës, veçanërisht në zonat që nuk kanë qasje në ujësjellës gjithashtu, në bashkëpunim me ekspertë dhe me GIZ-in gjerman, jemi duke punuar në hartimin e një projekti për ujë të pijshëm, me kapacitet deri në 300 litra në sekondë ky projekt tashmë ka avancuar dhe është në fazën përfundimtare. Shpresojmë që, përmes bashkëpunimit me nivelin qendror, të arrijmë ta realizojmë këtë projekt dhe ta zgjidhim në mënyrë afatgjatë çështjen e ujit të pijshëm për qytetarët e Klinës

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi! **Takimi u mbyll në ora 19:00**

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	10
Totali	10

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu

